



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 618/s Prot.

Durrës, më 05.03.2026

VENDIM

Nr. 26, datë 05.03 2026

PËR

**"HARTIMIN E SYLLABUS-eve EDHE NË GJUHËN ANGLEZE, PËR
PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", Statutit të UAMD-së, Rregullores së UAMD-së; në kuadër të ndërkombëtarizimit, si dhe referuar propozimit të NJSBC-së Institucionale me nr. 558 prot., datë 26.02.2026, në mbledhjen e datës 05.03.2026, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin për hartimin e syllabus-eve edhe në gjuhën angleze, për programet e studimit që ofrohen në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorja e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHME TË CILËSISË

Nr. 558 prot

Durrës, më 26.02. 2026

Lënda : Mbi hartimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e syllabus-eve edhe në gjuhën angleze

**PROF. DR. SHKËLQIM FORTUZI, KRYETAR
SENATI AKADEMIK
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"**

**Për dijeni: PROF. DR. LINDITA MUKLI, KRYETAR
KOMISIONI I PËRHERSHËM PËR
GARANTIMIN E STANDARDEVE DHE CILËSISË**

I nderuar Z.Rektor,

Në ushtrimin e rolit të saj këshillues dhe monitorues për garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucion, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në mbledhjen e saj të datës 26.02.2026 ka analizuar nevojën për forcimin e dokumentacionit akademik bazë në përputhje me standardet bashkëkohore europiane të arsimit të lartë. Në këtë kuadër, vlerësohet si një hap i domosdoshëm institucional hartimi, ruajtja dhe shpërndarja e syllabuseve të lëndëve edhe në gjuhën angleze, krahas gjuhës shqipe.

Syllabusi përfaqëson dokumentin themelor që pasqyron filozofinë akademike të lëndës, objektivat e të nxënës, përmbajtjen programore, metodat e mësimdhënies dhe kriteret e vlerësimit. Për këtë arsye, mënyra se si ai strukturohet dhe gjuhët në të cilat bëhet i aksesueshëm përbëjnë elementë thelbësorë të sigurimit të cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies akademike. Disponueshmëria e syllabus-eve në gjuhën angleze rrit ndjeshëm aksesin dhe kuptueshmërinë e këtij dokumenti për studentë, stafin akademik dhe partnerë ndërkombëtarë, duke e vendosur institucionin në një nivel krahasues me praktikën më të mira europiane. Në përvojën e universiteteve europiane, përfshirë ato të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, hartimi i syllabus-eve në anglisht konsiderohet tashmë një standard i konsoliduar, edhe në rastet kur programet zhvillohen në gjuhën kombëtare. Kjo praktikë shërben jo vetëm për transparencë, por edhe si një instrument funksional për njohjen e krediteve, lehtësimin e mobiliteteve Erasmus+, si dhe për ndërtimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta. Në këtë kuptim, mungesa e syllabus-eve në anglisht

Adresa: Lagja Nr.1, Rr "Faulantia", Durrës, Tel: +355 52 39161, www.uamd.edu.al.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
REKTORATI

përbën për ne shpesh një pengesë reale në proceset e bashkëpunimit ndërkombëtar, ndërsa prania e tyre e thjeshton ndjeshëm dialogun akademik dhe administrativ me institucionet partnere. Gjithashtu, raportet dhe rekomandimet e agjencive prestigjioze të sigurimit të cilësisë, si Quality Assurance Agency (QAA) në Mbretërinë e Bashkuar dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), theksojnë rëndësinë e dokumentacionit akademik të qartë, të strukturuar dhe të aksesueshëm në një gjuhën angleze. Në proceset e akreditimit dhe vlerësimit të jashtëm, syllabuset në gjuhën angleze përbëjnë një element lehtësues dhe pozitiv, duke rritur besueshmërinë, transparencën dhe përputhshmërinë e programeve të studimit me standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Një aspekt i rëndësishëm që vlen të theksohet është fakti se stafi akademik i institucionit është, në përputhje me kriteret ligjore dhe praktikat aktuale të punësimit, i kualifikuar në gjuhën angleze. Përvoja e shumicës së pedagogëve në mobilitete ndërkombëtare, projekte kërkimore dhe bashkëpunime me universitete të huaja krijon bindjen se hartimi i syllabuseve edhe në anglisht nuk përbën një vështirësi reale, por përkundrazi një proces të realizueshëm dhe të qëndrueshëm pa kosto shtesë. Në një plan më strategjik, ky veprim pritet të na favorizojë ndjeshëm në aspektin e ndërkombëtarizimit të institucionit. Disponueshmëria e syllabuseve në anglisht rrit ekspozimin akademik të programeve tona, lehtëson ndërtimin e marrëveshjeve për programe të përbashkëta, Erasmus Mundus, diploma të dyfishta dhe bashkëpunime të tjera ndëruniversitare, si dhe përmirëson pozicionimin e institucionit në rrjetet dhe renditjet e ndryshme akademike europiane dhe ndërkombëtare.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson se hartimi, për arsyet e sipërcituara, sugjeron që Senati Akademik ta marrë në shqyrtim dhe ta miratojë këtë nismë si pjesë integrale të politikave akademike të institucionit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin

Kryetar i NJSBC-së
Dr. Spiro Paço

Adresa: Lagja Nr.1, Rr "Taulantia", Durrës, Tel: +355 52 39161, www.uamd.edu.al